

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shifrat - Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin
ADRESA	https://www.syri.net/ekonomi/917478/gati-gjysma-e-shqiptareve-kane-veshtiresi-te-mbyllin-muajin-e-dyta-ne-europe/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:10:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 06:04:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	171b97af8e403ec1572cd1e389e855227bb847e000e002142dbf482b67f32df3
TEKSTI	70b28ccb1455e5e260db3f2c29e3fd9bc6d27d0914fa66c815e5d227b7bf32ac
PAMJA	d6177c065eb62dba27087ddf0218e1744f2b2d3c93e8a29f0957e94682afc42a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	57e2f96270c9a40e5ad9b7b51d8309bac14abd5f4799ca3732747da9c0f471e5
E MËPARSHMJA	80a56608448f6d6d2e810f3143d0f7ef8e1b163b23d5839a9db4693ca94bfde8
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/57e2f96270c9a40e5ad9b7b51d8309bac14abd5f4799ca3732747da9c0f471e5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



PROF. MYQEREM TAJ
Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!



SONILA MEÇO
"Në emër të popullit të Kosovës", prokura e një kurthi



më të lexuarat

Tarifa e re për krijimin e rezervës së sigurisë rrezikon të rrisë çmimet e naftës

Shpopullimi masiv/ Ikin të rinjtë, dyfishohet numri i pensionistëve të punësuar

KESH nis procedurën për të marrë në pronësi dy TEC-et lundruese të Vlorës! Pagoi 70 mln \$ për 2 asete jo rentabël

Thellohet kriza e prodhimit në Shqipëri/ Fasoni në rënie të pandalshme, zbritet në grupin e dytë

Credins Bank sjell Visa Infinite, kartën e parë metalike në Shqipëri!

SYRI TV/ Rritja e naftës dëmton fermerët, probleme te prodhuesit e pjeshkës në Elbasan



Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin

08:04, 18/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



"Duke menduar për të ardhurat totale të familjes suaj, a është familja në gjendje të mbyllë muajin, pra të paguajë shpenzimet e zakonshme të nevojshme?" Kjo është pyetja që Eurostat u bën familjeve në Europë, për të matur se sa mund ta përballojnë jetesën.

Për shumë familje shqiptare, mbyllja e muajit mbetet një mision i vështirë.

Në Shqipëri, 32.9% deklarojnë se e kanë të vështirë të mbyllin muajin, ndërsa 13.4% e kanë këtë problem në nivelin më të rëndë, duke thënë se e përballojnë jetesën me shumë vështirësi.

Të mbledhura bashkë, gati gjysma e popullsisë, konkretisht 46.3%, deklararon se e përballon jetesën me vështirësi ose shumë vështirësi, sipas të dhënave të Eurostat, që Shqipërinë, janë të disponueshme për vitin 2023.

Me këtë nivel, Shqipëria renditet e dyta në Europë, pas Greqisë, ku vështirësitë për të mbyllur muajin prekin një pjesë edhe më të madhe të popullsisë, në 67% (35% shumë të vështirë dhe 32% të vështirë). Ndërsa në Bashkimin Europian, mesatarja është vetëm 17.6% për kategoritë "me vështirësi" dhe "me shumë vështirësi", përkatësisht 11.2 dhe 6.4%, që i referohet vitit 2025.

Edhe në raport me rajonin, Shqipëria shfaqet në nivele të larta. Në Maqedoninë e Veriut përqindja e atyre që kanë vështirësi, ose shumë vështirësi të mbyllin muajin arrin në 43.8%, në Malin e Zi në 37.9% dhe në Serbi në 31.2%.

Pamundësia për të mbyllur muajin lidhet edhe me nivelin e pagave, që në Shqipëri mbetet ndër më të ulëtat në rajon.

Sipas të dhënave të publikuara më herët nga Monitor, paga mesatare bruto në Shqipëri arriti rreth 860 euro në muaj në vitin 2025.

Në të njëjtin vit, paga bruto ishte rreth 1,290 euro në Serbi, 1,245 euro në Bosnjë-Hercegovinë, 1,206 euro në Mal të Zi dhe rreth 1,100 euro në Maqedoninë e Veriut. Vetëm Kosova, kishte një pagë mesatare bruto më të ulët prej 713 eurosh

ne 2025-n.

Diferenca me Bashkimin European është edhe më e madhe: paga mesatare bruto vjetore për një punonjës me kohë të plotë në BE ishte rreth 39,800 euro në vitin 2024, ose rreth 3,317 euro në muaj.

Pagat bruto vjetore, Shqipëria në fund të listës me 10 mijë euro në vit, sa një e pesta e Europës

Presioni mbi buxhetet familjare shtohet edhe nga niveli i çmimeve. Në vitin 2025, çmimet e ushqimeve në Shqipëri arritën në 102.9% të mesatares së Bashkimit European, duke e kaluar për herë të parë nivelin mesatar european. Kjo e vendos Shqipërinë edhe në krye të rajonit për nivelin e çmimeve të ushqimeve, duke e bërë diferencën mes të ardhurave dhe koston së jetesës një tjetër faktor që rëndon mbi familjet.

Shqipëria shtrenjtohet më tej në 2025, çmimet e ushqimeve e kalojnë për herë të parë mesataren e BE

Si matet "Aftësia për të mbyllur muajin"

Sipas metodologjisë së Eurostatit, treguesi "Aftësia për të mbyllur muajin" bazohet në vlerësimin e familjes për nivelin e vështirësisë që përjeton për të përballuar shpenzimet e zakonshme, duke marrë në konsideratë të ardhurat totale të familjes dhe të gjitha burimet e të ardhurave, përfshirë edhe të ardhurat e parregullta.

Shpenzimet e zakonshme përfshijnë kostot e lidhura me banesën, ndërsa përfshihen shpenzimet e biznesit dhe të fermës.

Pyetja e përdorur në anketë është: "Duke menduar për të ardhurat totale të familjes suaj, a është familja në gjendje të mbyllë muajin, pra të paguajë shpenzimet e zakonshme të nevojshme?" Përgjigjet ndahen në gjashtë kategori: me shumë vështirësi, me vështirësi, me disa vështirësi, relativisht lehtë, lehtë dhe shumë lehtë. Për treguesin "me vështirësi ose me shumë vështirësi", Eurostat bashkon dy kategoritë e para.

Europa

Sipas Eurostat, në vitin 2025, 17.6% e popullsisë së BE-së përjetoi vështirësi ose shumë vështirësi për të mbyllur muajin.

Në skajin tjetër, 26.4% e popullsisë ishte në gjendje ta përballonte jetesën shumë lehtë ose lehtë. Ndërsa 56.1% e popullsisë e përballonte muajin relativisht lehtë ose me disa vështirësi.

Duke i grupuar gjashtë kategoritë e aftësisë për të mbyllur muajin në dy grupe – me vështirësi dhe pa vështirësi – rezulton se 42.5% e popullsisë së BE-së kishte të paktën disa vështirësi për të mbyllur muajin në vitin 2025.

Pesha e personave që kishin të paktën disa vështirësi ndryshonte ndjeshëm në Europë: nga 18.3% në Gjermani dhe 19.8% në Holandë, deri në 76.9% në Bullgari dhe 87.1% në Greqi./ [Monitor](#).

© SYRI.net

Lexo edhe:



Këmbimi valutor sot - Ja me sa blihen e shiten dollari dhe euro, si luhaten monedhat e tjera




Taksë e fshehtë mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria



Thellohet kriza e prodhimit në Shqipëri/ Fasoni në rënie të pandalshme, zbret në grupin e dytë

SYRI TV/ Fier, fermerët e misrit ankesa për prodhimin: Ky vit, rendimenti i ulët në fusha



Këmbimi valutor 16 shtator/ Me sa blihen e shiten euro, dollari e monedhat e tjera



Euro në rënie – Si paraqitet tregu valutor, çfarë ndodh me monedhat e tjera

TË NGJASHME



Tarifa e re për krijimin e rezervës së sigurisë rrezikon të rrisë çmimet e naftës



SYRI TV/ Fier, fermerët e misrit ankesa për prodhimin: Ky vit, rendimenti i ulët në fusha



SYRI TV/ Rritja e naftës dëmton fermerët, probleme te prodhuesit e pjeshkës në Elbasan



Credins Bank sjell Visa Infinite, kartën e parë metalike në Shqipëri!



Qeveria rikthen Bordin e
Transparencës për çmimet e
karburanteve



Këmbimi valutor 16 shtator/ Me sa
blihen e shiten euro, dollari e
monedhat e tjera



KESH nis procedurën për të marrë në
pronësi dy TEC-et lundruese të
Vlorës! Pagoi 70 mln \$ për 2 asete jo
rentabël

[LAJME](#) [POLITIKË](#) [KRONIKË](#) [EKONOMI](#) [KOSOVA](#) [BOTË](#) [KULTURË](#) [SHKENCË](#) [SPORT](#) [JETË/STIL](#) [TRASHËGIMI](#) [MEDIËS](#) [ARKIVA](#)



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.